

PRANUAR MË:  
ACCEPTED ON: 14/03/2026  
PRIMLJENO:  
12/31



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E MALISHEVËS  
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



RAPORT NJËVJEÇAR I PUNËS I DREJTORISË PËR KULTURË, RINI DHE  
SPORT  
(Periudha janar-dhjetor 2025)

Malishevë, mars 2026



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E MALISHEVËS  
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



RAPORT NJËVJEÇAR I PUNËS I DREJTORISË PËR KULTURË, RINI DHE  
SPORT  
(Periudha janar-dhjetor 2025)

Në periudhën janar-dhjetor, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, konkretisht sektorët për kulturë, rini dhe sport, kanë realizuar një sërë aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, të cilat janë pasqyruar në këtë raport.

**SEKTORI PËR KULTURË  
JANAR**

- Në fillim të muajit janar është hartuar plankocepti për shënimin e Flakës së Janarit, aktivitet ky i paraparë në planin e punës së sektorit për kulturë. Ky plankoncept, paraqet orientimin për realizimin e aktiviteteve në kuadër të shënimit të Flakës së Janarit. Lidhur me këtë janë bërë diskutime me kryetarin e komunës dhe me këshilltarin e tij Rexhep Mazreku.
- Në kuadër të shënimit të Flakës së Janarit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka shpallur konkursin letrar Flaka e Janarit. Në këtë konkurs kanë konkurruar mbi 100 poetë nga treva të ndryshme shqiptare. Për të realizuar këtë aktivitet, kemi caktuar jurinë krejtësisht të pavarurë dhe profesionale, në këtë përbërje: Dr.Salih Bytyçi, PHD, Astrit Jashari dhe Arta Maxhuni.
- Në kuadër të planifimit të aktiviteteve për Flakën e Janarit, zyrtari për Kulturë, Mehdi Krasniqi është takuar me ish-kryetarin e komunës, z. Daut Krasniqi, me të cilin ka diskutuar për mënyrën e hartimit të kumtesës për akademinë përkujtimore. Daut Krasniqi, ka siguruar të dhënat e sakta biografike për dy dëshmorët, listën e të plagosurve dhe të maltretuarve.
- Është hartuar dhe publikuar agjenda për realizimin e aktiviteteve të Flakës. Janë shpërndarë ftesat për institucionet e planifikuar për pjesëmarrje në akademi, janë ftuar familjet e dëshmorëve, përsoneat e plagosur dhe të maltretuarit.
- Pas mbylljes së konkursit letrar, më 27 janar 2025, është mbajtur ora letrare dhe janë ndarë tri çmimet letrare për konkurruesit e rritur dhe për të rinj. Megjë në konkurs kanë konkurruar edhe nxënës të shkollave të komunës së Malishevës, kemi krijuar edhe tri

çmime inkurajuese pa pagesë për poetët e rinj. Juria në përbërje: Dr.Salih Bytyçi, PHD, Astrit Jashari dhe Arta Maxhuni, ka vendosur që fitues të çmimeve letrare të jenë: 1.Shkurtë Kadriu-Çitaku (çmimi i parë,150.00 €), 2.Ruzhdi Berisha (Rudi) (çmimi i dytë, 100.00 €), 3.Hyrë Fazliu (çmimi i tretë, 50.00 €), ndërsa për poetët e rinj, fitues të çmimeve letrare inkurajuese pa pagesë janë” 1.Vesa Rudi- çmimi “Pena e së ardhmes I” dhe 2. Erisa Samadraxha- çmimi “Pena e së ardhmes II”. Për pjesëmarrësit në këtë orë letrare, është organizuar një koktej rasti që është mbajtur në byfenë e komunës.

- Më 30 janar është mbajtur akademja përkujtimore në nderim të ngjarjeve të janarit 1990 dhe rënies së dëshmorëve të kombit Ali Kryeziu dhe Hysni Mazreku si dhe të plagosurve, të burgosurve dhe të maltretuarve. Në këtë akademi fjalë rasti mbajti kryetari i komunës, z.Ekrem Kastrati, më pas me kumtesat e tyre u paraqiten: Daut Krasniqi, ish-kryetar i komunës, Prof.dr.Begzad Baliu dhe studiuesi i letersisë z. Prend Buzhala. Ndërsa në emër të familjeve foli Rrezartë Kastrati Mazreku. Pas akademisë, janë bërë homazhe te varri i dëshmorit Hysni Mazreku në Malishevë dhe te varri i dëshmorit Ali Kryeziu në Kijevë.

## SHKURT

- Në fillim të muajit shkurt zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi ka mbajtur takim pune me përfaqësuesit e SHKL “Tafil Kelmendi” me të cilët ka diskutuar në lidhje me orën letrare në kuadër të shënimit të 17 Shkurtit-Dita e Pavarësisë së Kosovës.
- Zyrtari për kulturë ka pritur në takim z. Rexhep Toplana, i cili ka informuar DKRS-në lidhur me çështjen e objektit të ish-bibliotekës së Kijevës. Dhe kërkoi që të shikohet mundësia që ky objekt të merret nën përkujdesje shtetërore. Gjithashtu, ai theksoi se për këtë, gjatë këtij muaji do ta dorëzojë edhe një kërkesë me shkrim, meqë ky objekt (sipas tij) është i vjetër dhe fillimisht është përdorur si objekt policor e si burg ku janë keqtrajtuar shqiptarët, pastaj është përdorur edhe si shtëpi kulture e si bibliotekë komunale. Për këtë, i është ofruar bashkëpunimi i DKRS-së dhe pas verifikimit të të dhënave do të shikojmë mundësinë për procedurat e mëtuqjeshme.
- Me qëllim të koordinimit të punëve rreth organizimit të shënimit të 17-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, janë zhvilluar takime pune me këshilltarin e kryetarit të komunës, z. Rexhep Mazreku. Fokus i takimit tonë ishte agenda, njoftimet dhe ftesat. Të gjitha aktivitetet që organizohen në shënimin e kësaj date theksuam se duhet të jenë në përkujdesjen e kryetarit të komunës.
- Më 14 shkurt, organizuar nga DKRS, SHKL “T.K” dhe Grupi letrar i gjimnazit “Hamdi Berisha” është mbajtur orë e letrare në nderim të Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Në këtë orë letrare morën pjesë: Mehdi Krasniqi, Fadil Javori, Izet Shala, Rexhep Toplana, Sahit Morina dhe Zymer Zogaj. Në emër të komunës i kam përshëndetur të pranishmit, ndërsa në emër të gjimnazit foli Argjend Morina. Poezitë e tyre i lexuan përveç anëtarëve të shoqatës edhe poetët e rinj-anëtarë të grupit letrar të këtij gjimnazi.
- Më 17 shkurt, është shënuar Dita e Pavarësisë së Kosovës. Fillimisht është mbajtur seancë solemne në kuvendin e komunës në të cilën kanë marrë pjesë familjarë të familjeve të dëshmorëve të kombit, qytetarë të shumtë, ndërsa aktivitetet kanë vazhduar me hamazhe te varrezat e dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe Prekaz.
- Zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi, bashkë me drejtoreshën e Departamentit të Kulturës nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, ka vizituar familjen e rapsodëve (Sefë Mleqani). Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja me hapësirën ku pritet të ndërtohet muzeu i Sefë Mleqanit.

## MARS

- Në kuadër të shënimit të Epopesë së UÇK-së, është mbajtur akademi përkujtimore dhe janë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe Prekaz.
- Më 7 mars, për nder të Ditës së Mësuesit dhe përkujtimit të Epopesë së UÇK-së, në bashkëpunim me Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” dhe SHKL “Tafil Kelmendi” është organizuar orë letrare në Qendrën e Kumpetëncës. Në këtë letrare poezitë e tyre i lexuan nxënësit e kësaj shkolle dhe anëtarët e shoqatës: Fadil Javori, Izet Shala, Zymer Zogaj, Rexhep Toplana.
- Bazuar në kërkesën e Rexhep Toplanës, nr.12/29, zyrtari për kulturë ka dalë në terren dhe ka vizituar objektin e ish-bibliotekës së Kijevës dhe ish-shtëpisë së kulturës. Qëllimi i vizitës ishte të shikohet gjendja e objektit dhe sipas kërkesës së parashtruar të shihen pastaj edhe mundësitë për ta marrë në mbrojtje si objekt me vlerë të trashëgimisë kulturore (për këtë është përgatitur një raport i veçantë).
- Në kuadër të vizitave me karakter pune, zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi ka zhvilluar vizitë në mullirin e begajve në Banjë, objekt ky me vlerë të trashëgimisë kulturore dhe që është nën përkujdesjen e shtetit. Gjatë vizitës nuk është vërejtur ndonjë ndryshim.

## PRILL

- Në fillim të muajit prill është organizuar një akademi nderimi dhe ceremoni rivarrimi për martirët e kombit nga fshati Llapqevë dhe Bubavec, të zhdukur që nga lufta. Në këtë akademi kanë marrë pjesë familjarë, përfaqësues të institucioneve dhe qytetarë të shumtë.
- Takim pune me përfaqësuesit e OSBE-së lidhur me përgatitjen e një katalogu me prezantime të vlerave të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe për Rregulloren për Këshillat Rinore. Zyrtari i kulturës, Mehdi Krasniqi, ka kërkuar mbështetjen OSBE-së për finalizimin e katalogut dhe botimin e tij, ndërsa për rregulloren për këshillat rinore dhamë vërejtjet tona meqë e njëjta kërkon themelimin e KVRL-ve pa e konsideruar se komuna e jonë dhe disa komuna të tjera kanë të themeluara KVRL, dhe disa nga këto edhe janë të regjistruara në DOJQ.
- Bashkë me zyrtarë të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve nga Prizreni kemi vizituar mullirin e Zenel Islamit në fshatin Pagarushë. Zyrtarët e Institutit kërkuar në zyrën për kadastër hartat e vjetra të fshatit Pagarushë për të parë ndryshimet që kanë ndodhur ndër vite në atë zonë.
- Në kuadër të bashkëpunimit institucional, zyrtari për kulturë Mehdi Krasniqi ka zhvilluar takim pune me drejtoreshën e Departamentit për Kulturë, znj. Jehona Shyti, me të cilën ka diskutuar çështjen e dokumentacionit të trashëgimisë kulturore që mungon në komunën e Malishevës. Ky dokumentacion është i rëndësishëm për krijimin e dosjeve dhe të databazës për trashëgimi kulturore. Përveç kësaj diskutuam edhe për çështjen e kullës së të Bijve të Sefë Mleqanit për të cilën tashmë janë nisur procedurat për ndërtimin e saj.
- Me qëllim të hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik, është mbajtur tækimi i parë i grupit punues. Në këtë takim ka marrë pjesë zyrtari për kulturë Mehdi Krasniqi dhe aty është diskutuar për format dhe mënyrën se si ta hartojmë këtë strategji. Takimi është organizuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm

## MAJ

- Në kuadër të aktiviteteve për librin zyrtari për kulturë Mehdi Krasniqi ka zhvilluar aksion për për mbledhjen e librave me qëllim të pajisjes së bibliotekës së SHFMU “Ismet Jashari-Kumanova” të fshatit Temeqinë. Për këtë qëllim ka vizituar krijues letrarë nga komunat Gjilan, Klinë, Prishtinë. Nga ky aksion janë mbledhur 550 libra të cilat janë dhuruar nga : Ismet Krasniqi- Lala, Ramadan Mehmeti, Sabit Rustemi, Drita Kosumi-Syla, Shaqir Foniqi, Rexhep Toplana, Mentor Mazreku dhe Selajdin Mazreku (Libraria “Arbri”).
- Me ftesë të Këshillit Organizativ për shënimin e 44-vjetorit të demonstratave në Kijevë, Mehdi Krasniqi ka marrë pjesë në aktivitetin që u organizua në shkollën e Kijevës. Në këtë organizim morën pjesë profesorë, pjesëmarrës të ngjarjeve të asaj kohe dhe qytetarë.
- Me qëllimin që të shtohet dashuria për librin dhe leximin, në bashkëpunim me karvanin e Shkrimtarëve për Fëmijë “Agim Deva”, mbështetur edhe nga Drejtoria për Arsim dhe Edukim, zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi ka realizuar orë letrare në SHFMU “ Emin Duraku” në Dragobil dhe në SHFMU”Ganimete Terbeshi” në Astrazup. Në të dyja shkollat pritja ishte madhështore ndërsa fëmijët e gëzuar lexuan poezitë e tyre, recituan dhe dëgjuan me vëmendje poezitë e poetëve për fëmijë.

## QERSHOR

- Organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe SHKA "Oda e Kijevës", me program kulturo-artistik për fëmijë u shënuar Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve. Në këtë aktivitet morën pjesë nxënës të shkollave të ndryshme të komunës sonë dhe fëmijët nga çerdhet. Aktiviteti është realizuar në Shtëpinë e kulturës "Tahir Sinani" në Malishevë<sup>1</sup>.
- Në bashkëpunim me karvanin e Shkrimtarëve për Fëmijë “Agim Deva”, mbështetur edhe nga Drejtoria për Arsim dhe Edukim, zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi ka realizuar orë letrare në SHFMU “ Habib Berisha” në Gurbardh dhe në SHFMU ”Ramadan Morina” në Damanek. Në fillim të orës lexuan krijimet e tyre nxënësit e shkollave, ndërsa më pas lexuan poezitë e tyre poetët për fëmijë, anëtarë të karvanit. Pas leximit të poezive, nxënësit shtruan pyetjet e tyre rreth librave dhe këshut u krijua një kohë e mirë bashkëbisedimi. Poetët për fëmijë kërkuan nga nxënësit që të lexojnë sa më shumë libra dhe të mos humbin kohën e tyre në rrjete sociale.
- DKRS, sektori për kulturë, ka filluar përgatitjet për shënimin e 16 Qershorit-Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Janë përgatitur ftesat, agjenda dhe njoftimi.
- Në kuadër të shënimit të 16 Qershorit-Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, zyrtari për kulturë Mehdi Krasniqi ka pajisur me libra bibliotekën e SHFMU”Ismet Jashari-Kumanova” të fshatit Temeqinë. Ky aktivitet është organizuar në bashkëpunim edhe me Drejtorinë për Arsim dhe Edukim. Bashkë me zyrtarin e DAE-së, librat ia dorëzuan drejtorit të shkollës, z. Hajriz Zabelaj. Për mbështetjen në këtë pasurim të fondit librar i falënderova të gjithë dhuruesit e librave (Mentor Mazreku, Seljadin Mazreku-pronar i librarisë “Arbri”, Ramadan Mehmeti, Sabit Rustemi, Shaqir Foniqi, Drita Kosumi-Syla, Ismet Krasniqi, Rexhep Toplana).
- Zyrtari për kulturë, me autorizim të Kryetarit të Komunës kam përgatitur aplikacionin për Programin ReLOaD3 të UNDP-së për aplikim në grande për komunën e Malishevës. Për

<sup>1</sup> Punë shtesë në ditë pushimi (e diel, më 1 qershor 2025)

këtë gjë, jam caktuar nga kryetari i komunës nëpërmjet vendimit të tij. Pas përgatitjes së aplikacionit dhe nënshkrimit të tij nga kryetari i komunës dhe nga unë si person i autorizuar e kam dorëzuar atë në UNDP, nëpërmjet formës së apikimit dhe e-mail adresës zyrtare.

- Është shënuar 16 Qershori-Dita e Çlirimit dhe Dita e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Fillimisht është mbajtur një akademi solemne ku janë ndarë Çmimet për Trimëri dhe heroizëm, për Arsim dhe për Shëndetësi. Pas akademisë, është mbajtur edhe një program artistik me aktorin e njohur, z. Basri Lushtaku dhe SHKA "Oda e Kijevës". Në këtë aktivitetet anë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme, qytetarë të shumtë dhe familjarë të familjeve të dëshmorëve e veteranë të luftës së UÇK-së.
- Zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi ka mbajtur takim pune me zyrtarët e OSBE-së, znj. Flutura Hoxha dhe Zilha Nurkullari për mundësinë e mbajtjes në shkolla të mesme të komunës së Malishevës të ligjeratave vetedijesuese për trashëgiminë kulturore dhe për hartimin e katalogut me prezantime të objekteve të trashëgimisë kulturore të komunës së Malishevës. Ligjeratat planifikojmë t'i mbajmë bashkë me institucionet kompetente dhe OSBE në tetor të këtij viti. Zyrtarët e OSBE-së, kërkuan informacione për realizimin e idesë dhe më njoftuan se për këtë do të bisedojnë konkretisht me zyrën e OSBE-së në qendër.

#### KORRIK

- Në fillim të muajit korrik zyrtari për kulturë Mehdi Krasniqi është takuar me kryetaren e OJQ "Fatjona", znj. Fatime Limaj, me të cilën ka diskutuar për organizimin e panairit artizanal në kuadër të festivalit folklorik "Oda e Llapushës". Me qëllim të organizimit, ajo kërkoi që panairi të jetë nën përgjegjësinë e saj, por në mbështetje të komunës.
- Komuna e Malishevës është përzgjedhur partnere në programin ReLOad3 të UNDP-së që financohet nga BE-ja.
- Zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi ka kontaktuar Qendrën për Trashëgimi Kulturore në Prizren lidhur me çështjen emrit të pronarit të mullirit në Pagarushë që ka qenë në procedurë të ndryshimit nga **Mulliri i Islam Zenelit në Mulliri i Zenel Islam Kryeziu** siç kanë kërkuar familjarët. Nëpërmjet e-mailit zyrtar, QRTK, ka njoftuar se është bërë ndryshimi i emrit të pronarit të mullirit dhe tani e tutje mulliri do të quhet **Mulliri i Zenel Kryeziu**.

#### GUSHT

- Në zyrën e kryetarit të komunës është nënshkruar marrëveshja në mes të komunës dhe UNDP-së për programin ReLOaD3. Marrëveshja është nënshkruar nga Kryetari i Komunës, z. Ekrem Kastrati dhe përfaqësuesja e UNDP-së, znj. Vlorë Elshani. Ky program do ta fuqizojë jo vetëm komunën, por edhe sektorët për kulturë, rini dhe sport.
- Në kuadër të vizitave në terren, zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi ka vizituar gërmadhat e kullës së Avdyl Balës (Hoti) në Carrallukë, për të parë nëse ka ndonjë ndryshim nga gjendja e mëparshme, konkretisht nga vizitia e zyrtarëve të Qendrës për Trashëgimi Kulturore në Prizren. Nga ajo që pashë në terren, gjendja ishte e njëjtë. Rrënojat e kullës, përshtirë dhe një pjesë e themeleve të kullës janë ende, ndonëse të njëjtat edhe mund të dëmtohen nga faktori kohë.

## SHTATOR

- Në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet DKRS-së dhe UNDP-së u realizua takimi i parë me grupet punuese të komunave fituese të programit ReLOaD3. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për pyetësorët, për analizimin e praktikave ekzistuese, kapacitetet e komunave në lidhje me bashkëpunimin me OSHC-të. Unë kam folur ludhur me mënyrën se si organizojme ne punën me OSHC-të, procedurat lidhur me thirrjet publike dhe kapacitetet tona financiare. Pjesë e takimit ishte edhe anëtari i grupit nga Malisheva, z. Albert Morina.
- Në cilësinë e koordinatorit të grupit për programin ReLOaD3, zyrtari për kulturë Mehdi Krasniqi ka plotësuar pyetësorin për analizimin e praktikave ekzistuese, kapaciteteve dhe nevojave të komunës së Malishevës në lidhje me bashkëpunimin me OSHC. Janë mbledhur të dhënat nëpër drejtori të ndryshme dhe janë vendosur në dokumentin e formatit pyetësor.
- Zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga INTEGRA dhe GiZ në Prizren me përfaqësuesit e komunave të Kosovës. Në këtë takim janë prezantuar të arriturat dhe sukseset nga projekti i organizatës me të cilat komunat kanë bashkëpunuar.
- Zyrtari për kulturë Mehdi Krasniqi ka pritur në zyrë inspektorët e Inspektoratit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, z.Pajtim Zogaj dhe znj. Laberie Dakaj. Inspektorët e njoftuan zyrtarin e DKRS-së se kanë zhvilluar një inspektim të asetit të trashëgimisë kulturore në Bubël. Bëhet fjalë për urën e Bublilit. Në këtë takim, diskutuam ndër të tjera edhe mundësinë e pajisjes së komunës me dokumentacionin apo dosjet e aseteve dhe gjerave të tjera me vlerë nga trashëgimia kulturore që ekzistojnë në listën e trashëgimisë nën mbrojtje të përkohshme dhe mbrojtje të përhershme.

## TETOR

- Zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi ka vizituar mullirin e begajve në fshatin Banjë, për të parë nga afër gjendjen e këtij aseti me vlerë kulturore. Gjendja e objektit është e mirë dhe nuk vërehen ndryshime apo dëmtime.
- Me qëllim të pasurimit të fondit librar të bibliotekave të shkollave të komunës së Malishevës, Mehdi Krasniqi ka vazhduar aksioninin për pasurimin e bibliotekës së SHFMU "Habib Berisha" në Gurbardh.

## NËNTOR

- Zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi ka marrë pjesë në Konferencën Ballkanike në kuadër të programit ReLOaD që është mbajtur në Shkup. Në këtë konferencë janë shkëmbyer përvojat e OSHC-ve dhe institucioneve të shteteve, si: Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Basnjë e Hercegovina, Maqedonia dhe Serbia. Në fund të konferencës janë nxjerrë edhe rekomandimet e grupeve punuese nga vendet pjesëmarrëse.
- Kemi filluar përgatitjet për shënimin e Festave të Nëntorit. Për këtë zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi ka zhvilluar takim zyrtar me Blerta Krasniqi-shefe e Kabinetit të Kryetarit të Komunës dhe këshilltarin e Kryetarit të Komunës, z. Rexhep Mazreku. Në këtë takim u diskutua për përgatitjen e njoftimit, ftesave, shpërndarjen e ftesave dhe planifikimin e pjesëmarrësve në programin kulturor-artistik.
- Është shënuar 28 Nëntori-Dita e Flamurit, ditëlindja e komandantit legjendar Adem Jashari dhe dalja publike e UÇK-së. Shënimi ka filluar me mbledhjen solemne në sallën e

kuvendit ku janë mbajtur fjalime nga kryetari i komunës, z. Ekrem Kastrati, përfaqesuesi i shoqatave të dala nga lufta z. Metush Kryeziu dhe pas me pika muzikore janë paraqitur këngëtarët Valbona Krasniqi, Mujë Telaku, ndërsa me një recitim është paraqitur Vesa Rudi. Pas programit kulturor, në mënyrë të organizuar janë bërë nderime te varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe në Kleçkë.

#### DHJETOR

- Zyrtari për Kulturë, Mehdi Krasniqi ka përfunduar trajnimin pesëmodulësh dhe është certifikuar zyrtarisht për programin ReLOaD të UNDP-së. Ky trajnim dhe ky certifikim përbën shtim të njohjeve të reja në këtë fushë por edhe forcim të kapaciteteve për komunën e Malishevës, konkretisht për DKRS-në.
- Zyrtari për kulturë, Mehdi Krasniqi ka realizuar takim pune me përfaqësuesen e angazhuar nga UNDP, znj. Fixhrie Thaçi. Në takim kemi diskutuar për mënyrën e financimit të OSHC-ve sipas modelit të komunës në kuadër të Rregullores MF-NR.04/2017. E kam njoftuar për organizimin që bën komuna jonë lidhur me këtë çështje. Përveç takimit, është realizuar edhe një pyetësor lidhur me realizimin e aktiviteteve, procedurave në kuadër të thirrjes publike për subvencionimin e OJQ-ve.
- Nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, është përkujtuar rapsodi emblematik Ali Krasniqi dhe është bërë përrurimi i librit “Rapsodi Ali Krasniqi-fisniku i këngës” i autorëve Ismet Krasniqi dhe Januz Mazreku. Në emër të komunës, foli nënkryetari Vesel Krasniqi, ndërsa për librin folën Prend Buzhala-redaktor, dhe Idriz Berisha, i cili lexoi recensionin e Prof.Dr.Behar Arllatit. Trashëgimtarët e këngës dhe folklorit nga familja Krasniqi kënduan këngë të ndryshme, ndërsa mbesa e tij e vogël, Ronela, recitoi një poezi kushtuar rapsodit Ali Krasniqi. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme, rapsodë, krijues letrarë nga Tirana, Tropoja, Klina, Ferizaj, Skënderaj, Drenasi, Prishtina, Rahoveci.

#### SEKTORI PËR BIBLIOTEKA

- Në fillim të vitit, menaxherja për biblioteka Hana Bytyçi dhe zyrtarja Lumturie Bytyçi kanë filluar me anëtarësimin e lexuesëve njëjtë sikurse viteve të mëparëshme:
  - Shkolla fillore
  - Shkolla mesme
  - Të rrituritNumri i lexuesëve, për këtë vit është 143 lexues, duke filluar nga nxënësit deri tek pensionerët.

#### SHKURT

- Në Muajin shkurt menaxherja për biblioteka Hana Bytyçi dhe zyrtarja Lumturie Bytyçi kanë realizuar aktivitete me nxënës të SHFMU „Ibrahim Mazreku“ në Malishevëme klasët IV, V dhe VI së bashku me mësimmhënësit, me temën: “Njohuri nga biblioteka,puna si dhe standardet e bibliotekës”. Poashtu nxënësit janë prezentuar me poezi dhe tregime për t'u ndërlidhur me temën në fjalë.

#### PRILL

- Në muajin Prill, për Ditën e Libritv menaxherja për biblioteka Hana Bytyçi dhe zyrtarja Lumturie Bytyçi kanë realizuar aktivitete me nxënësit e Qendrës së Kompetencës

„Kujtim Krasniqi“ në Malishevë. Nxënësit u njoftuan me historikun e bibliotekës dhe shumë prej tyre u anëtaresuan si lexues të rregullt në bibliotekë.

- Në bibliotekë u hapën zyrtarisht aktivitetet kundër dhunës në familje, të organizuara nga Zyra për Barazi Gjinore. Eshtë mbajtur një takim i zgjeruar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucione të ndryshme, përfshirë sektorin e arsimit, shëndetësisë, QPS-në, policinë, shkollat, Zyrtarin për Ndhimë Juridike Falas si dhe bashkëpunëtorë të tjerë të zyrës. Hapja zyrtare e kësaj nisme është realizuar në ambientet e bibliotekës, jo rastësisht, duke e lidhur atë me bazën e edukimit dhe arsimimit, si faktorë të rëndësishëm në parandalimin e dhunës. Të pranishëm ishin edhe pjesëmarrës të interesuar, të cilët janë lexues të librave që trajtojnë sfidat dhe sukseset e grave që kanë arritur të jenë të njohura në jetën shoqërore dhe politike. Gjatë takimit, secili nga pjesëmarrësit, në bazë të fushës së tij të veprimtarisë, dha kontributin e vet në diskutim, i cili u vlerësua si i frytshëm dhe konstruktiv për krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe më të barabartë për të gjithë. Po ashtu, nxënësit pjesëmarrës (lexues të bibliotekës) lexuan ese të përgatitura prej tyre lidhur me parandalimin e dhunës në familje, të vendosura në këndin e leximit të bibliotekës, duke dhënë një mesazh të fortë ndërgjegjësimi dhe reflektimi.

#### TETOR

- Në kuadër të muajit tetor – muajit rozë, i dedikuar sensibilizimit për parandalimin e kancerit të gjirit u zhvillua një lojë miqësore në volejball nga vajzat e Klubit të Volejbollit, si një formë kreative dhe motivuese për të përçarur mesazhin e rëndësishëm së kontrollave të rregullta shëndetësore, vetëdijesimit dhe mbështetjes për gratë që përballen me këtë sëmundje.
- Përmes aktiviteteve të zhvilluara me nxënësit kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe dhunës në familje, si dhe përmes promovimit të librit dhe leximit, biblioteka ka kontribuar në forcimin e vlerave të respektit, barazisë dhe dinjitetit njerëzor.

Angazhimi ynë do të vazhdojë edhe në vitet në vijim, me synimin për të ndërtuar një komunitet më të ndërgjegjshëm, më të informuar dhe më të mbrojtur nga dukuritë negative.

#### Pasurimi i fondit librarë

Përgjatë vitit 2025 fondi librarë është pasuruar vetëm me libra të dhuruara nga autorë të Komunës së Malishevës dhe jashtë saj.

#### Vërejtje:

Shumë libra kanë mbetur tek lexuesit të cilat janë në lexim gjatë viteve paraprake, jane njoftuar shkollat dhe poashtu lexuesit që librat të kthehen në bibliotekë, shpresojmë që brenda vitit pjesa më e madhe e librave do të kthehet.

## SEKTORI PËR RINI

### JANAR

- Në fillim të muajit janar, zyrtarja për rini Aferdita Duraku ka ërgatitur planin e punës për sektorin e rinisë për vitin 2025. Plani i ri i punës është hartuar në përputhje me nevojat e të rinjve të komunës së Malishevës.
- Në fillim të janarit, DKRS- sektori për rini ka përgatitur konkursin për licencimin e Qendrës Rinore. Ky konkurs është përgatitur sipas UA që rregullon këtë çështje, ndersa shpallja nuk është bërë për shkak se objekti i Qendrës është jashtë funksionit.
- Zyrtarja për rini, Aferdita Duraku, ka ndihmuar zyrtarin për kulturë në organizimin e aktiviteteve për shënimin e Flakës së Janarit.

### MARS

- Zyrtarja për rini ka ndihmuar në zhvillimin e aktiviteteve për nder të Epopesë së UÇK-së. Në vazhden e aktiviteteve për EPOEPENË E UÇK-së është mbajtur një mbledhje solemne në Kuvendin e Komunës, janë organizuar vizita në varrezat e dëshmorëve në Malishevë, Kleçkë dhe në Prekaz.
- Zyrtarja për rini, Aferdita Duraku ka ndihmuar në organizimin e shënimit përkujtimor të 25-vjetorit të masakrës së Burimit. Ky përkujtim, është organizuar nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati. Në kuadër të këtij shënimi është mbajtur një mbledhje përkujtimore dhe janë bërë homazhe në varrezat e martirëve në Dragobil dhe në Burim, te vendi i rëniës së 42 martirëve- qytetarë, kryesisht nga fshati Astrazup dhe Dragobil.

### QERSHOR

- Zyrtarja për rini, bashkë me zyrtarët e DKRS-së, ka zhvilluar takime pune me qëllim të organizimit sa më dinjitoz të Ditës së Çlirimit të komunë sonë. Ndërsa, më 16 qershor, është bërë shënim i Ditës së Çlirimit dhe i Dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Fillimisht është mbajtur mbledhja e Kuvendit të Komunës, ku janë ndarë çmimet e kuvendit.

### KORRIK

- Zyrtarja për rini ka zhvilluar takim pune me menaxheren e Qendres Rinore në Malishevë, ku ka biseduar për aktivitetet e përbashketa që do të realizohen gjatë vitit.

### GUSHT

- Zyrtarja për rini Aferdita Duraku, ka zhvilluar takim me organizatën YMCA, e cila në bashkëpunim me ATRC dhe me mbështetje nga Banka. Botërore është duke implementuar projektin "Bëje Tënden" që synon edukimin dhe vetëdijesimin e të rinjve dhe të rejave rreth së drejtës së barabartë në trashëgimi dhe prone. Ky aktivitet synon fuqizimin e zërit të të rinjeve në raport me të drejten në prone trashigimi dhe barazi gjinore, përmes dialogut të drejtëpërdrejt me përfaqesues institucjonalë dhe profesionist të fushës.

## TETOR

- Zyrtarja për rini Aferdita Duraku ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga OSBE për prezantimin e Kornizës së re ligjore për rininë me theks të veçantë mbi themelimin dhe funksionimin efektiv të Këshillave, Rinore Lokale. Në këtë takim zyrtarja e DKRS-së theksoi nevojën e themelimit të këtij këshillimi i cili do të luaj rol në fuqizimin e rinisë në komunën e Malishevës.

## NËNTOR

- Zyrtarja për rini, ka ndihmuar zyrtarin për kulturë, në organizimin e Festave të Nëntorit. Aktivitetet janë realizuar nën përkujdesjen e kryetarit të komunës së Malishevës, z. Ekrem Kastrati. Pas mbledhjes është bërë vendosja e kurorave me lule dhe janë zhvilluar homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë.

## DHJETOR

- Zyrtarja për rini ka punuar në përgatitjen e planit të punës dhe ka përgatitur raportin vjetor për vitin 2025.

## SEKTORI PËR SPORT

### JANAR

- Zyrtari për sport, Albert Morina, në muajin janar ka bërë hartimin e planit vjetor për vitin 2025, për aktivitetet të cilat do të zhvillohen në sketorin e sportit gjatë kësaj periudhe.
- Zyrtari për sporti, Albert Morina ka zhvilluar takime me disa nga përfaqësuesit e klubeve sportive ku ka diskutuar për çështje të ndryshme sportive, për vështësitë me të cilat përballen këto klube.
- Bashkë me zyrtarin për sport Albert Morina kemi vizituar Stadiumin e qytetit “Liman Gegaj” si dhe Palestrën e qytetit “Habib Zogaj”. Nga zyrtarët që punojnë aty u njoftuam lidhur me aktivitetet të cilat zhvillohen në këto terrene sportive.

### SHKURT

- Zyrtari për sport Albert Morina ka marrë pjesë në shënimin e 17- Shkurtit-Ditës së Sshpalljës së Pavarsisë së Republikës së Kosovës. Në realizimin e aktiviteteve sipas agjendës së paraparë, Albert Morina ka ndihmuar DKRS-në në realizimin e aktiviteteve.

### MARS

- Zyrtari për sport Albert Morina ka ndihmuar në organizimin e aktiviteteve të organizuara për shënimin e "Epopesë së UÇK- së". Në kuadër të shënimit, është organizuar akademi përkujtimore në sallën e kuvendit.
- Drejtori Fitim Shalabashkë me zyrtarin për sport, Albert Morina, në kuadër të aktiviteteve të drejtorisë kanë vizituar stadiumin e qytetit “Liman Gegaj” në Malishevë si dhe palestrën e qytetit “Habib Zogaj” në Malishevë.

### PRILL

- Gjatë muajit prill zyrtari për sport Albert Morina ka realizuar takime me disa nga përfaqësuesit e klubeve sportive ku është diskutuar për çështje të ndryshme sportive. Është

diskutuar gjendja e vështirësuar me pjesëmarrjen e për vështersit me të cilata përballen këto klube sportive të cilata bëjnë gara në nivele të ndryshme garuese.

#### MAJ

- Bashkë me zyrtarët Albert Morina dhe Arton Kafexholli, kam zhvilluar takime me disa nga përfaqësuesit e klubeve sportive ku është diskutuar për çështje të ndryshme sportive. Ky takim është organizuar në vazhden e takime me klube sportive. Takimet do të vazhdojnë edhe me disa OJQ të tjera sportive.

#### QERSHOR

- Për nderë të 16 Qershorit ditës së Çlirimit dhe ditës Dëshmorve të Malishevës në bashkpunim me klubin e Futsallit Malisheva është organizuar turnir në futboll të vogël për meshkuj në qenderën sportive “Fusha Jonë” në Lumishtë, ku pjesëmarrës ishin 80 ekipe nga vend të ndryshme të Kosovës, fituesit në këtë turnir ishin:  
-Vendi i parë: KF Nili Shpk  
-Vendi i dytë: KF Mon ami lounge bar.  
Në fund, fituesit u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Numri i pjesëmarrësve në këtë aktivitet ishte 800 sportistë, ndërsa numri i shikuesve 1500.

#### KORRIK

Bashkë me zyrtarin për sport Albert Morina, gjatë këtij muaji kemi vizituar Stadiumin e qytetit “Liman Gegaj” si dhe palestrën e qytetit “Habib Zogaj” ku jemi njoftuar nga punëtorët e këtyre institucioneve lidhur me aktivitetet të cilat zhvillohen në keto terrene sportive gjatë kësaj kohe.

- Zyrtari për sport Albert Morina ka zhvilluar takime me disa nga përfaqësuesit e klubeve sportive ku është diskutuar për çështje të ndryshme sportive, për vështersitë me të cilat përballen këto klube sportive që bëjnë gara në nivele të ndryshme garuese.

#### GUSHT

- Gjatë këtij muaji në ambientet e pishinës së Banjës u zhvillua gara memoriale e notit “Esmir Shala”, e organizuar nga Klubi i Notit Besa nga Malisheva, në bashkëpunim me Federatën e Notit të Kosovës. Në këtë aktivitet sportiv morën pjesë 17 ekipe nga mbarë Kosova me gjithsej 120 notarë duke e bërë këtë garë një ngjarje të rëndësishme për sportin e Notit. Gjatë zhvillimit të kesajë gare ishim prezentë së bashkë me Kryetarin e Komunës z. Ekrem Kastrati, i cili përshëndeti organizatorët dhe pjesëmarrësit, në shenjë mirënjohjeje për mbështetjen e vazhdueshme ndaj sportit, Federata e Notit e Kosovës i ndau Kryetarit Kastrati një mirënjohje të veçantë.  
Pas garaës u shpërblyen më të mirët:  
Kategoria e meshkujve:  
Vendi i parë – Klubi i Notit Step (Prishtinë)  
Vendi i dytë – Klubi i Notit Besa (Malishevë)  
Vendi i tretë – Klubi i Notit Kastrioti (Ferizaj)

Kategoria e femrave:

Vendi i parë – Klubi i Notit Step (Prishtinë)

Vendi i dytë – Klubi i Notit Ilirida (Fushë Kosovë)

Vendi i tretë – Klubi i Notit Kosova (Prizren)

Ky aktivitet, përveç që nderoi kujtimin e Esmir Shalës, shërbeu edhe për të promovuar sportin e notit dhe për të forcuar frymën garuese mes të rinjve nga e gjithë Kosova.

#### TETOR

- Zyrtari Albert Morina dhe zyrtari Arton Kafexholli kanë pasur takime me disa nga përfaqësuesit e klubëve sportive ku është diskutuar për çështje të ndryshme sportive. Kemi biseduar për vështersit me të cilata përballen këto klube sportive që bëjnë gara në nivele të ndryshme garuese.

#### NËNTOR

- Në kuadër të shënimit të 28 Nentorit zyrtari pwr sport, Albert Morina, ka marrë pjesë në shënimin e aktiviteteve të organizuara nga komuuna për nder të kësaj date. Është mbajtur mbledhje solemne në sallwn e Kuvendit dhe më pas është bërë vendosja kurorave me lule dhe janë zhvilluar homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë dhe Kleçkë.

#### DHJETOR

- Zyrtarët për sport Albert Morina dhe Arton Kafexholli kanë marrë pjesë në Turnirin Memorial “Drinor Berisha” i cili është organizuar nga Shkolla e Futbollit FC Malisheva-edicioni i dytë. Në këtë turnir morën pjesë shumë shkolla të futbollit nga komuna të ndryshme të Kosovës.  
Kampion i këtij turniri u shpall FC Malisheva  
Nënkampion u shpall AF Yjet- Drenas  
Ndërsa në vendin e tretë u rendit SHF Grande –Malishevë.  
Në fund të turnirit fituesit u shpërblyen me kupa dhe mirënjohje nga organizatori.  
Ky aktivitet u zhvillua në palestren sportive “Habib Zogaj” në Malishevë.

Malishevë, dhjetor 2025

U.D. e Shefes së DKRS-së  
Valentinë Krasniqi - Zogaj

